



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 214/4 Prot

Tiranë, më 26/2 /2019

VENDIM

Nr. 02, datë 26.2 .2019

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Qendra "Birn Albania", përfaqësuar nga z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri") Formularin e Ankesës nr. 214 Prot., datë 07.02.2019, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare", kundër Autoritetit Publik "Autoriteti Rrugor Shqiptar" (në vijim quajtur "Autoriteti Publik").

Ankuesi në cilësinë e kërkuesit, me shkresën e datës 07.01.2019, ka kërkuar nga Autoriteti Publik t'i vihet në dispozicion dokumentacioni i disponueshëm në lidhje me:

1. *Kopje të kontratës dhe anekseve shoqëruese Nr. 6706/6, datë 24.09.2018, me palë: Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe C O B I A L.*

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankimin nr. 214 Prot., datë 07.02.2019, pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes me Urdhrin nr. 45, datë 11.02.2019, vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik, me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave, që mund të jenë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Gjatë inspektimit u kontaktua me Koordinatorën për të Drejtën e Informimit pranë këtij Autoritetit Publik, e cila sqaroi se: "Kërkesa e Qendrës "BIRN Albania" është depozituar

në ARRSH dhe regjistruar me nr. Prot. 309., datë 10.01.2019. Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH-së, kjo kërkesë është deleguar për trajtim, me siglim të veçantë në Kartelën Shoqëruese të Brendshme, po në datë 10.01.2019, për Drejtorin e Drejtorisë Juridike dhe Përputhshmërisë dhe Përgjegjësen e Sektorit të Prokurimeve pranë kësaj drejtorie në ARRSH. Për shkak të largimeve nga detyra të punonjësve të sipërcituar, kjo kërkesë nuk është trajtuar në afat. Menjëherë pas ndryshimeve të ndodhura pranë ARRSH-së, kjo kërkesë iu delegua për trajtim më datë 08.02.2019, Përgjegjësit të Sektorit të Prokurimeve dhe Specialistes së Sektorit të Prokurimeve pranë Drejtorisë Juridike dhe Përputhshmërisë në ARRSH". Në përfundim të inspektimit nga ana e personave të ngarkuar, u kërkuar kohë për trajtimin e kësaj kërkesë dhe vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar brenda datës 15.02.2019.

Pas parashtrimit të fakteve u hartua procesverbali i cili u nënshkrua pa vërejtje nga ana e përfaqësuesëve të Autoritetit Publik.

Me shkresën nr. 309/1 Prot., datë 15.02.2019, Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje duke refuzuar vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar me argumentin se: "Parashikimet e kontratës nr. 6706/6, datë 24.09.2018 dhe anekseve shoqëruese, detyrojnë palët të ruajnë konfidencialitetin në lidhje me të. Konkretisht, në nenin 5 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (pjesë e DST-ve) sanksionohet se: "Neni 5- Informacioni konfidencial: Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën".

Me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" në të cilin citohet se "Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale... Kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve", me shkresën nr. 214/3 Prot., datë 18.02.2019, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore, e cila u zhvillua me prezencën e përfaqësuesit të Qendrës "Birn Albania" nga njëra anë dhe përfaqësuesve të Autoritetit Publik nga ana tjetër.

Gjatë seancës, palët rikonfirmuan qëndrimet e tyre të reflektuara në aktet shkresore të trajtuara më sipër.

Nga shqyrtimi i çështjes konstatohet se objekti i kërkesës ka të bëjë me një kontratë punësh publike, e cila i nënshtrohet dispozitave të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar. Neni 25 i këtij ligji përcakton kufizime mbi Autoritetin Publik lidhur me publikimin e informacionit të marrë nga operatorët ekonomikë, të cilësuar si konfidencial, duke përfshirë në këtë kategori aspektet teknike, sekretet tregtare si dhe informacionet konfidenciale të ofertave.

Siç mund të vërehet nga dispozita e mësipërme, konfidencialiteti lidhet me aspekte teknike, sekrete tregtare dhe të dhëna të tjera konfidenciale me të cilat Autoriteti Publik është njohur ose i janë vënë në dispozicion nga operatorët ekonomikë gjatë procesit të prokurimit publik. Pra në këtë përcaktim nuk përfshihet kontrata për punë publike e cila edhe nga vetë emri është vetëshpjeguese për natyrën e saj. Për sa më sipër, Komisioneri

vlërëson se argumenti i dhënë nga Autoriteti Publik për mosdhënien e informacionit nuk rezulton i bazuar në ligj. Për më tepër, edhe nëse do të kishte aspekte konfidenciale, në frymën e nenit 17 pika 6 e Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, sipas të cilit *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*, Autoriteti Publik, duhet të kishte vlerësuar kufizimin e pjesëve të kontratës të cilat sipas gjykimit të tij i nënshtrohen kufizimeve të trajtuara më sipër, duke vënë në dispozicion të kërkuarit pjesën tjetër të tij.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, informacioni i kërkuar në parim përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe kufizimet e pasqyruara në legjislacionin e zbatueshëm nuk prekin në mënyrë tërësore informacionin e kërkuar. Në këto kushte, personat përgjegjës duhet ta vënë atë në dispozicion të kërkuarit në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit të sipërcituar.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

Bazuar në sa është parashtruar më sipër, vërehet se qëndrimi i Autoritetit Publik, pavarësisht përgjigjes së dhënë kërkuarit, në thelb përbën refuzim për dhënien e informacionit të kërkuar.

Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, përfaqësuesi i Autoritetit Publik, pohoi se është ai personi përgjegjës për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar në cilësinë e Përgjegjësit të Sektorit të Prokurimeve pranë Drejtorisë Juridike dhe Përputhshmërisë në Autoritetin Rrugor Shqiptar. Kjo, vërtetuar gjithashtu dhe nga praktika e administruar nga Zyra e Komisionerit, në të cilën rezultoi se, kërkesa e Qendrës “Birn Albania” është deleguar nga titullari i Autoritetit Publik për trajtim pranë këtij sektori, duke mos vënë në dijeni Koordinatorin për të Drejtën e Informimit pranë këtij Autoriteti Publik. Grupi i inspektimit konstatoi se kjo e fundit mori dijeni për praktikën në fjalë në momentin e paraqitjes së grupit të inspektimit pranë Autoritetit Publik.

Sa më sipër, për rastin konkret, Përgjegjësi i Sektorit të Prokurimeve në Autoritetin Rrugor Shqiptar, ka marrë përsipër dhe ka vepruar në cilësinë e koordinatorit *ad hoc* për të drejtën e informimit.

Në bazë të nenit 18, pika 2, gërma a) e Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” refuzimi për dhënien e informacionit, në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë e cila varion nga 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) Lekë deri në 300.000 (treqind mijë) Lekë.

Theksojmë, se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet

parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funkzionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Qendrës "Birn Albania" ndaj Autoritetit Rrugor Shqiptar, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në shkronjën a) të pikës 2 të nenit 18, pikën 3 të nenit 18, pikën 3 të nenit 19, pikat 1 dhe 2 të nenit 21, nenin 22, shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 'Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative', i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankimit nr. 214 Prot., datë 07.02.2019 të Qendrës "Birn Albania", përfaqësuar nga z. _____, kundër Autoritetit Publik "Autoriteti Rrugor Shqiptar", me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar (*Kopje të kontratës dhe anekseve shoqëruese Nr. 6706/6, datë 24.09.2018, me palë: Autoriteti Rrugor dhe COBIAL*), brenda datës 5.3.2019.
3. Dënimin e Përgjegjësit të Sektorit të Prokurimeve pranë Drejtorisë Juridike dhe Përputhshmërisë në Autoritetin Publik, z. _____, në cilësinë e personit përgjegjës, me gjobë në vlerën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë në përputhje me nenin 19, pika 3 e ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit". Masa e dënimit me gjobë, shlyhet me këste mujore. Gjoha ekzekutohet nga zyra e financës së Autoritetit Publik brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Kundër vendimmarrjes në pikat 1, dhe 2, palët kanë të drejtën e ankimit brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit".
5. Kundër vendimmarrjes në pikën 3, personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni administrativ, ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 22 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit".
6. Ky vendim u shpall sot në datë 26.2.2019.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

